



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 27/04/2020

- I. Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 23.04.2020, të parashtruar nga Grupi i Operatorëve Ekonomik "D&T group"sh.p.k & "Florida"sh.p.k. & "Horn"&Co Kosova"sh.p.k, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja e autorrugëve" – pj.I-rë: "Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane", me Nr. 632-19-7809-2-1-1, Nr. Brendshëm 632-18-072-211.

nxjerr:

V E N D I M

- II. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Grupi i Operatorëve Ekonomik "D&T group"sh.p.k & "Florida"sh.p.k. & "Horn"&Co Kosova"sh.p.k, të dt. 23.04.2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit Mirëmbajtja e autorrugëve" – pj.I-rë: "Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane", me Nr. 632-19-7809-2-1-1, Nr. Brendshëm 632-18-072-211, kundër Njoftimit MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES , te AK –së, të datës 21.04.2020, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së .

2. Vërtetohet NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES të publikuar me datë: 21.04.2020;

1. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit;
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të ju dorëzohet palëve/

Arsyetim

I. Grupi i Operatorëve Ekonomik "D&T group" sh.p.k & "Florida" sh.p.k. & "Horn"&Co Kosova" sh.p.k, me datë 09.12.2019, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull **Mirëmbajtja e autorrugëve** – pj.l-rë: **"Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane",** me Nr. 632-19-7809-2-1-1, Nr. Brendshëm 632-18-072-211.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 27.04.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

1. Kemi kërkuar: *Referenca e lëshuar nga SH.P.K. "NOTI BETON", të sqarohet se për çfarë punime bëhet fjalë (a është kontratë e natyrës së njëjtët? a ka mirëmbajtje të rrugëve në këtë kontratë?), të bashkëngjiten dëshmitë që tregojnë se ka qenë kontratë e punimeve të natyrës së ngjashme siç është ky tender*

Kemi konstatuar: Kontrata e lidhur në mes të SH.P.K. "NOTI BETON" dhe INOVA shpk & D&T Group, përkatësisht neni 2 i saj tregon se palët janë dakorduar për ndërtim të kolektorit të betonarme dhe kanalizimit fekal në rrugën mbi lumin Prishtina, - ky aktivitet i prokurimit kërkon që operatori të ketë eksperiencë në mirëmbajtje të rrugëve. Ju nuk keni ofruar dëshmi që gjatë implementimit të kësaj kontrate keni kryer punë të tilla.

2. Kemi kërkuar: *Referenca e lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me dt. 23.10.2019 të sqarohet se për çfarë punime bëhet fjalë (a është kontratë e natyrës së njëjtët? a ka mirëmbajtje të rrugëve në këtë kontratë?)*

Kemi konstatuar: Referenca dhe Kontrata e lidhur në mes të Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe D&T Group, nuk ka as një dëshmi që D&T Group ka kryer punë në mirëmbajtje të rrugëve apo hapësirave publike. Ka ofruar vetëm një deklaratë me shkrim në të cilën pohon se ka kryer punë në kthimin e gjendjes së më pashme të rrugëve, mirëpo deklarin nuk e ka mbështetur me dëshmi siç janë pozicionet e paramases në kontratë.

3. Kemi kërkuar: *Për kontratën me nr. 02/410/04-30828 te dt. 08.11.2018 "Sanimi dhe Ndërtimi i Pendave te Kanaleve te Ujitjes" të tregohet se a është kontratë e natyrës së*

njëjtët (a ka mirëmbajtje të rrugëve në këtë kontratë?), po ashtu mungon referenca andaj ju lutem qe ta na siguroni referencën ne fjale;

Kemi konstatuar: Në kontratën me nr. 02/410/04-30828 te dt. 08.11.2018 "Sanimi dhe Ndërtimi i Pendave te Kanaleve te Ujitjes" të Komunës së Gjakoves, nuk ka as një pozicion të mirëmbajtës së rrugëve, në sqarime ju keni bashkangjitur referencën e cila është lëshuar pas datës së mbylljes së aplikimit për këtë tender 05.11.2019, përkatësisht referencat janë të datës 07.02.2020 dhe 02.03.2020.

4. Kemi kërkuar: *Referenca e lëshuar nga "FLORIDA" sh.p.k., me dt.28.12.2017 për D&T Group e bazuar në kontratën e nënshkrua në mes të Florida shpk dhe D&T Group e cila është e datës 30.12.2017, ndërsa kontrata me titull "Mirëmbajtja Rutinë e Dimërore Rruga Bajram Curri – Firze, U. Dushaj – Sheshi i Trageteve, Sheshi i Trageteve – Lekbibaj 31.5 km" e lidhur në mes të "FLORIDA" sh.p.k. dhe Autoritetit Rrugor Shqiptar (DRV) tregon se ka përfunduar me datë 23.12.2017, si është e mundur që kontrata në mes të Florida shpk dhe D&T Group është nënshkruar pasi që ka përfunduar kontrata e Florida shpk me Autoritetit Rrugor Shqiptar (DRV)?! Operatori Florida shpk referon se D&T Group ka kryer punime si nën kontraktor, për këtë shërbim operatorët kanë lidhur kontratë pas skadimit të kontratës bazë! Ju lutemi të na sqaroni këtë kontraktim?*

Kemi konstatuar: Kemi të bëjmë me ndryshim material, pra në sqarime është sjellur kontratë me datë tjetër nga ajo që është dorëzuar në e-prokurim, për këtë keni deklaruar edhe ju se keni bërë lëshim. Mirëpo nëse e analizojmë tutje këtë kontratë pika e parë e marrëveshjes juaj me Florida shpk është të kryeni të gjitha shërbimet e pastrimit të rrugëve nga bora, Ju si operatorë nuk keni as një dëshmi që posedoni makineri për kryerjen e punëve të tilla, si ka mundësi që i keni kryer punë në vlerë 205,000.00 €!

5. Kërkohet nga lideri i këtij konsorciumi deklarim me shkrim se a e plotëson kushtin si lider i grupit siç është kërkuar në FDT (pika 9.1 & 9.2 te pjesa e kantatave), nëse po, të sqarohen vlerat e referencave (totali i tyre) dhe natyra e punëve të tyre (referencat duhet të përmbajnë kontrata në të cilat është kryer shërbim në mirëmbajtje të rrugëve).

Kemi konstatuar: Se keni bashkangjitur një kontratë me titull "Mirëmbajtja rutinë e dimërore Rruga Ura e Bujanit – Qafë morinë, Sopot Kernaj, Mejdan – Tropoje – Buçaj 30.76 km", kjo kontratë prapë është shtim material sepse nuk rezulton në listën tuaj që e keni dorëzuar në e-prokurim.

Konstatim:

Operatori D&T Group si lideri i këtij koncerziumi, me dëshmitë e ofruara edhe pas sqarime shtesë të kërkuara, nuk na ka bindur se e plotëson kushtin minimal me qenë lider i grupit ashtu siç është kërkuar në pikat 9.1 & 9.2 të FDT-ës, pra nuk ka dëshmuar me referenca se ka kryer punë në vlerë minimale të kërkuar dhe të natyrës së njëjtë siç është kërkuar në FDT.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

Arkivit të Komunës

Faton Gutaj
Menaxher i Zyrës së Prokurimit

